

Dashamir SHEHI



Datëlindja:28.10.1957

Vendlindja:Tiranë

Email:Dashamir.Shehi@parlament.al

Jetëshkrimi

Dashamir Shehi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Ekonomisë Agrare në Kamëz (1976-1980). Më 1991 u emërua sekretar i Partisë Demokratike në Tiranë. Ka shërbyer si Deputet i Kuvendit të Shqipërisë (1992 – 1997) dhe më (1993 – 1996) ka qenë anëtar i Kryesisë së PD-së. Më 1992 - 1994 pati portofolin e Ministrisë së Punës, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë. Më 1994 - 1996 qe zëvendëskryeministër dhe ministër i Ndërtimit dhe i Turizmit.

Më 17 korrik të vitit 2002 krijon dhe bëhet kryetar i Partisë Demokratike të Rinovuar, e cila me vonë gjatë vitit 2004 merr emrin Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK), siç njihet deri në ditët e sotme. Më 2005 ka qenë kryetar ekzekutiv i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar (LZHK).

Në vitin 1995 ka marrë titullin “Doktor i Shkencave Ekonomike”.